



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 20.6.2024

Nr: 59

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

SHQYRTIMIN E REZULTATIT TË VERIFIKIMIT TË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM PËR SUBJEKTIN VETËDEKLARUES Z. MARK PAL NIKA, KANDIDAT PËR ANËTAR NË KËSHILLIN E BASHKISË LEZHË, I PROPOZUAR NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR "PARTIA SOCIALDEMOKRATE", PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Sot më datë 20.6. 2024, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në seancë publike shqyrtova çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues z. Mark Pal Nika, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Lezhë, i propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Socialdemokrate", në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Palë të interesuara: Z. Mark Pal Nika, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Lezhë, i propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Socialdemokrate", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Baza ligjore: Nenet 19, pikat 1, shkronja "n" e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenet 90 dhe 95, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative", i ndryshuar, ligji nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", pikat 12 dhe 13 të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike",

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

Data: 20.6.2024 Nr: 59
Ora: 12:00



"Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues z. Mark Pal Nika, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Lezhë, i propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialdemokrate"

VËREJ:

I.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për disa subjekte ndër të cilat është edhe “Kandidati /Anëtari në Këshillin e Bashkisë”.

Në zbatim të këtyre dispozitave, z. Mark Pal Nika, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Lezhë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, më datë 28.3.2023, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, formularin e vetëdeklarimit me nr. unik LE-PSD 5733. KQZ bëri verifikimin “prima facie” dhe pasi konstatoi se kandidati nuk është në kushtet e ndalimit, ndërmori hapat e mëposhtme:

- a. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, e cila nga ana e saj informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se subjekti vetëdeklarues z. Mark Pal Nika, rezulton i rehabilituar në bazë të nenit 69 të Kodit Penal.
- b. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile, e cila nga ana e saj informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se subjekti vetëdeklarues z. Mark Pal Nika, nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.

II.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, verifikoi të dhënat në formularin e vetëdeklarimit të subjektit vetëdeklarues z. Mark Pal Nika.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Mark Pal Nika, rezulton se ka deklaruar:

- Në rubrikën I. “TË DHËNA PERSONALE”, PIKA B, “Gjeneralitete të mëparshme” të Formularit të Vetëdeklarimit, subjekti vetëdeklarues nuk ka deklaruar gjeneralitete të mëparshme.
- Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit,
- Pyetjes 1 “A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga ndonjë autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “Po” duke deklaruar: “Gjykata e Lezhës. Dënim me paraqitje , pa patentë.
- Pyetjes 5 “A keni qënë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e një veprë penale? subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “Po” duke deklaruar: “Bazel Zvicër 2016. Mungesë dokumentacioni”.
- Pyetjes 8 “A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se 1 muaj? subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “Po” duke deklaruar: Se ka jetuar në “Itali në periudhën 2000- 2010 për arsye emigracioni ”, “Zvicër në periudhën 2016” për arsye turizmi dhe “Gjermani në periudhën 2014”, për arsye turizmi.

Nga konstatimet e mësipërme dhe bazuar në nenin 8, pika 1, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e Integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreu V, pika 2, shkronja “c”, të Vendimit të Kuvendit, nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 5000 prot., datë 11.5.2023, vendosi t’ia kalojë rastin për verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, si institucioni kompetent që kryen verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra.

Me shkresën nr. 776/42 prot.extra 23, datë 29.05.2024, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, vendimin “Për miratimin e rezultatit të verifikimit për subjektin z. Mark Pal Nika, Prokuroria e Përgjithshme, pas kryerjes së gjithë verifikimeve përkatëse, i konsideron këto të fundit të plota dhe të bazuara në nenin 8, pikat 1 dhe 2, të lidhura me nenin 5 të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” si dhe në përcaktimet e pikës 3 shkronja “ç”, Kreu III dhe pikave 10, 11, 12 e 13 të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, ka miratuar rezultatit e verifikimit të subjektit vetëdeklarues z.Mark Pal Nika, sipas të cilit konstatohet si më poshtë:

- Nuk rezulton të ketë ndryshime në gjeneralitete por rezulton se ka përdorur në Zvicër edhe gjeneralitetet alias Matteo Trentino i datëlindjes 05.05.1995.
- Rezulton që të jetë dënuar:
 - Nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me vendimin e formës së prerë nr.90, datë 24.02.20214, për kryerjen e veprës penale “Drejtimit automjeti në mënyrë të parregullt” parashikuar nga neni 291 të Kodit Penal me 6 (gjashtë) muaj burgim që në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale i është ulur me 4 (katër) muaj burgim, dhe në zbatim të nenit 63 të Kodit Penal i është pezulluar ekzekutimi i dënimit me burgim duke e zëvendësuar me detyrimin që të përmbushë një punë në interes publik për një kohë prej 100 orësh punë pranë një organizatë apo enti publik;
 - Nga Prokuroria Publike e Kantonit Bazel-Stadt Zvicër me urdhërin penal të datës 4 nëntor 2016, për kryerje të veprimeve penale të hyrjes së paligjshme dhe falsifikim i kartave të identitetit , me gjobë 30 tarifa ditore prej 30,00 CHF dhe 400,00 CHF gjobë. Në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë këto vepra penale parashikohen në nenin 189 prg.1 dhe nenin 296.
- Nuk rezulton i dënuar me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor për një çështje penale të pazgjydhur me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- Rezulton të ketë qënë në hetim dhe gjykim nga:
 - Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë në kuadër të procedimit penal nr. 946, të regjistruar më datë 09.12.2013, për kryerjen e veprës penale “Drejtimit automjeti në mënyrë të parregullt” parashikuar nga neni 291 të Kodit Penal, i dërguar për gjykim më datë 23.12.2013, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë që e ka deklaruar fajtor dhe dënuar me vendimin e formës së prerë nr.90, datë 24.02.2014;
 - Prokuroria Publike e Kantonit Bazel - Stadt, Zvicër në kuadër të procedimit penal V161104 - 093 për hyrje të paligjshme dhe falsifikim i kartave të identitetit i deklaruar fajtor dhe dënuar me Urdhër Penal datë 4 nëntor 2016.
- Rezulton të ketë qënë:
 - i arrestuar në flagrancë më datë 08.12.2013, nga Policia gjyqësore pranë Komisionariatit të Policisë Lezhë, si i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Drejtimit automjeti në mënyrë të parregullt” parashikuar nga neni 291 të Kodit Penal, vleftësuar e ligjshme me vendimin nr.284, datë 11.12.2013, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, që ka urdhëruar lirimin e menjëhershëm të tij nga gjendja e paraburgimit.

- i arrestuar në flagrancë më datë 3 nëntor 2016, nga organet ligjzbatuese të Aeroportit në Foig/Bazel Zvicër dhe dërguar në Zyrën e Migracionit në Bazel -City/Zvicër, si person i identifikuar me karta identiteti italiane të falsifikuara të raportuara të vjedhura në sistemin e informacionit Shengen SIS;
- Rezulton ti jetë caktuar ndaj tij:
 - masë sigurimi personale “Detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore”, të parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale, me vendimin nr.284 të datës 11.12.2013 , nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, si i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Drejtimit automatizuar në mënyrë të parregullt” të parashikuar nga neni 291 të Kodit Penal deri më datën 06.03.2014;
 - masa shtrënguese e distancimit për 12 ditë bazuar në nenin 67 ligji për të Huajt, vendosur më datë 4 nëntor 2016, nga Zyra e Migracionit në Qytetin Bazel, për ekzekutimin e dëbimit nga Zvicra e cila është vleftësuar i ligjshëm dhe përshtatshëm për periudhën nga data 3 nëntor 2016 (15:35) deri më datë 15 nëntor 2016, me vendimin e datës 7 nëntor 2016 nga Gjykata e Apelit të Kantonit të Bazel - City si gjykatë administrative gjyqtari i vetëm për masa shtrënguese në të drejtën e huaj;
- Nuk rezulton të jetë lëshuar ndaj tij urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e ndonjë veprë penale;
- Rezulton të jeta dëbuar më datë 09.11.2016, nga territori i Zvicrës me urdhër të Zyrës së Migracionit në qytetin Bazel, pasi është deklaruar fajtor dhe dënuar nga Prokuroria Publike e Kantonit Bazel-Stadt Zvicër me Urdhërin Penal të datë 4 nëntor 2016, për hyrje të paligjshme dhe falsifikim të identitetit;
- Nuk rezulton të ketë të tjera indicie apo të dhëna a rrethana, fakte të bëra publike apo informacion me qëllim verifikimi të mëtejshëm:
 - për veprimtari kriminale të kryer jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
 - për qënien në hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj;
 - për urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e ndonjë veprë penale prej tij;
 - dëbime nga territori i ndonjë shteti jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
 - përdorimin e të dhënave personale/gjeneraliteteve.

III.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe rezultatit të verifikimit të thelluar, të Prokurorit të Përgjithshëm konstaton se subjekti vetëdeklarues z. Mark Pal Nika, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Lezhë, i propozuar nga Partia Socialdemokrate nuk përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2, të ligjit 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë. Referuar të dhënave të disponuara, kandidati nuk është në kushtet e ndalimit të kandidimit/moszgjedhshmërisë. Partia Socialdemokrate në Këshillin e Bashkisë Lezhë, ka fituar 7 (shtatë) mandate dhe z. Mark Pal Nika, kandidat i listës shumëmemërore të Partisë Socialdemokrate, në Këshillin e Bashkisë Lezhë, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023, nuk ka marrë mandatin e anëtarit të këshillit.

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 90 dhe 95 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pikat 12 dhe 13 të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

V E N D O S:

1. Konstatimin se z. Mark Pal Nika, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Lezhë, i propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialdemokrate, nuk përfshihet në kushtet e ndalimit për të ushtruar funksionin publik të anëtarit.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI